



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 735/ Prot.

Tiranë, më 08.04.2026

VENDIM

Nr. 22 Datë 08.04 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E BURSIVE TË STUDENTËVE DHE PËRJASHTIMIN NGA  
TARIFA E SHKOLLIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, PËR VITIN  
AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 43 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, me VKM nr. 39 datë 23.01.2019, VKM 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve... që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 32 datë 23.06.2025 "Për miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurs regjistrimit të fituesve për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve dhe tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve në UST", në Vendimin nr. 52 datë 22.10.2025 "Për miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe reduktim me 50% nga tarifa e studimit për studentët e ciklit të dytë, për vitin akademik 2025-2026 në UST", në Relacionin e Komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit me Nr. 688 prot., datë 31.03.2026 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për aplikimet për bursë dhe përjashtim nga tarifa e studimit për ciklin e parë të studimeve", në relacionin e Adm. Nr 719 prot. datë 03.04.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 08.04.2026,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë, dhe për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2025-2026, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 1, tabelat bashkëngjitur;
2. Shpenzimet për bursat e studentëve mbulohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2025-2026, dhe efektet financiare llogariten sipas datës së aplikimit.

3. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë dhe me efektet financiare duhet të dërgohet në MA dhe AKFAL.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtorja e Financës dhe Buxhetiti, FVFR ,Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).


**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**




**Kriteri nr.1: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike**

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti	Efekti Financiar i perjashtimit	Efekti i Bursës
1		Elda Lila	360	18.02.2026	FVFR	1	17,500	43,636
Total							17,500	43,636

Alsona Ivani



Sonila Shera



Eduard Meçaj

